

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

MINISTRISË SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**NË FUSHËN E HETIMEVE ADMINISTRATIVE, TATIMORE DHE
DOGANORE**

Ministria e Financave të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Administrata Tatimore dhe Dogana, dhe Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në vijim të referuara si “Palët”;

DUKE marrë parasysh rëndësinë e vlerësimit të saktë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera dhe duke siguruar zbatimin e duhur të masave të kontrollit tek mallrat e ndaluara dhe ato të kufizuara;

ME QËLLIM të inkurajimit të zyrtarëve të zbatimit të ligjit për përdorimin e ndihmës së ndërsjellë ndërshtetërore, që do t’i shtoj vlerë procesit të hetimeve administrative, dhe do të ndihmojë zhvillimin e bashkëpunimit ndërshtetërorë në çështjet hetimore në përgjithësi;

DUKE marrë parasysh se shkeljet administrative ndaj Ligjeve përkatëse në të dyja anët e kufirit janë të dëmshme për sigurinë e ekonomisë, mbarëvajtjen fiskale, mirëqenien shoqërore, shëndetin publik dhe interesat kulturore;

TË BINDUR se veprimet kundër shmangieve të tatimeve dhe parandalimit të ekonomisë jo-formale mund të bëhen më efektive me bashkëpunim të ngushtë në mes të administratave Doganore dhe Tatimore të palëve nënshkruese, në bazë të dispozitave të dakorduara reciprokisht në këtë dokument;

DUKE pasur parasysh rezultatin pozitiv të bashkëpunimit të deritanishëm në mes të palëve;

DUKE u mbështetur në rekomandimet që rrjedhin nga iniciativa dhe organizata ndërkombëtare, përfshirë Organizatën Botërore të Doganave, rekomandimet e Këshillit Evropian për Hetimet sipas konceptit të Njësisë të Përbashkëta të Hetimit (JIT);

DUKE pasur parasysh konventat ndërkombëtare që përmbajnë ndalimet, kufizimet dhe masat speciale të kontrollit në lidhje me mallra të caktuara; si dhe Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948,

DUKE u mbështetur në:

- Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë, Lidhur me Tatimet mbi të Ardhurat dhe mbi Kapitalin dhe për Parandalimin e Evazionit Fiskal, nënshkruar më 28.3.2014;
- Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore, nënshkruar më 6.10.2009;

Palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Fushe e veprimit

1. Kjo marrëveshje rregullon bashkëpunimin në fushën e hetimeve administrative si dhe hetimeve tatimore dhe doganore të përcaktuara përkatësisht në përputhje me fushën e kompetencave midis institucioneve të fushës së tatimeve dhe doganave të autoriteteve të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, siç janë përcaktuar në pikën 2 dhe 3 të këtij neni.
2. Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë:
 - a. Administrata Doganore e Republikës së Shqipërisë,
 - b. Administrata Tatimore e Republikës së Shqipërisë,
 - c. Dogana e Republikës së Kosovës, dhe
 - d. Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës.
3. Autoritete kompetente do të konsiderohen edhe entitetet trashëguese në rast të ndryshimeve në statusin ligjor të institucioneve të përmendura në pikën 2 përfshirë proceset e shkrirjes eventuale të institucioneve/agjencive në një të vetme në njërin anë të territorit, përveç nëse palët konsiderojnë se duhet të ndërmarrin ndryshime/plotësime të nevojshme mbi bazën e kësaj marrëveshjeje.
4. Marrëveshja do të formalizojë edhe çështjet e këmbimit të burimeve në mes të palëve, me qëllim të pasurimit të proceseve hetimore si dhe do të parashtrojë premisa për adresim të përbashkët të aktiviteteve të hulumtimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të palëve.
5. Në rast se ekzekutimi i kësaj marrëveshjeje bie ndesh me dispozita të marrëveshjeve tjera të bashkëpunimit, e kur qëllimi nuk është tipik për të përdorur ndihmesën në një procedurë hetimore, dispozitat e marrëveshjeve tjera do të mbizotërojnë.
6. Nëse zbatimi i një apo më shumë dispozitave të dakorduara në këtë marrëveshje nuk është në harmoni me ligjet e brendshme të cilësdo palë, zbatimi i marrëveshjes do të përfundojë me vendim të palës, ligji i së cilës nuk lejon zbatimin e marrëveshjes dhe pala që ka marrë këtë vendim, do të njoftojë me shkrim palën tjetër sa më parë që të jetë e mundur. Njoftimi do të përmbajë informacione të sakta mbi dispozitat ligjore që pengojnë zbatimin e marrëveshjes.

Neni 2 Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim që të formalizojë dhe strukturojë ndihmën dhe ndërveprimin e proceseve hetimore administrative në veçanti dhe fushës së zbatimit të ligjit në përgjithësi.

Neni 3 Shkëmbimi i informacionit

Secila palë, sipas kërkesës ose me nismën e vet vendos në dispozicion të palës tjetër informacionin mbi aktivitetet e planifikuara, të filluara, ose që kanë përfunduar, e të cilat paraqesin bazë të arsyeshme për të besuar se një vepër e shkeljes së ligjit të ndonjëres palë sipas kësaj Marrëveshjeje, është kryer ose do të kryhet në territorin e tyre.

Neni 4 Korrespondenca e kërkesave për ndihmë në procesin e hetimeve administrative, tatimore dhe doganore

1. Kërkesat për ndihmë sipas kësaj Marrëveshjeje do t'i drejtohen drejtpërdrejt personit të kontaktit të caktuar nga ana e palës tjetër dhe në varësi të fushës që është përgjegjësi e administratës që i është drejtuar kërkesa. Secila administratë do të caktojë një person kontakti për këtë qëllim.
2. Kërkesat për ndihmë sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim dhe do të shoqërohen nga një informacion që konsiderohet i dobishëm për qëllimin e përmbushjes së kërkesave të tilla.
3. Kur rrethanat e kërkojnë, kërkesat mund të bëhen verbalisht, me kusht që një kërkesë e tillë të konfirmohet sa më shpejt që të jetë e mundur ose me shkrim, ose në qoftë se është e pranueshme për të dy Administratat sipas legjislacionit të brendshëm, përmes komunikimit elektronik.
4. Kërkesa për ndihmë sipas kësaj Marrëveshjeje do të përfshijë, por pa u kufizuar në to, të dhënat e mëposhtme:
 - (a) emrin e administratës kërkuese;
 - (b) çështjen në fjalë, llojin e ndihmës së kërkuar dhe arsyet për kërkesën;
 - (c) një përshkrim të shkurtër të çështjes në shqyrtim dhe dispozitat ligjore administrative që zbatohen;
 - (ç) emrat dhe adresat e personave për të cilët lidhet kërkesa, nëse dihen.
5. Kur pala kërkuese kërkon që të ndiqet një procedurë apo metodologji e caktuar, pala të cilës i është bërë kërkesa, do të veprojë në përputhje me kërkesën specifike, në varësi të lejimeve që mundësojnë dispozitat ligjore dhe administrative në fuqi.

6. Dokumentet origjinale do të kërkohen vetëm në rastet kur kopjet do të jenë të pamjaftueshme, dhe do të kthehen sa më parë që të jetë e mundur. Këto kërkesa do t'i dërgohen palës kërkuese, vetëm nëse një gjë e tillë konsiderohet e justifikueshme, ligjore dhe në rast se nuk cenon sigurinë e arkivit apo interesat e palëve të treta.

Neni 5

Kontrollet dhe Njësitë e Përbashkëta Hetimore

1. Palët kontraktuese mund të nisin kontrolle të sinkronizuara dhe të krijojnë njësi të përbashkëta të hetimit tatimor dhe/ose doganor, me qëllim që të zbulojnë dhe parandalojnë lloje të caktuara të shkeljeve disiplinore në fushën e tatimeve dhe doganave, të cilat kërkojnë aktivitete të njëkohësishme dhe të koordinuara.
2. Njësitë e Përbashkëta Hetimore, duhet të operojnë në pajtueshmëri të plotë me kompetencat e dispozitat ligjore dhe procedurat e palës në territorin e së cilës janë duke u bërë veprime hetimore.
3. Secila palë do të lejoj qasjen e nevojshme të palës tjetër në procesin e hetimit, për atë sa lejojnë dispozitat ligjore dhe duke siguruar autorizimin e prokurorit apo gjyqtarit, aty ku është e domosdoshme.

Neni 6

Prania e zyrtarëve në territorin e Palës tjetër me kërkesë të palës kërkuese

1. Sipas kërkesës, zyrtarët e përcaktuar nga administrata kërkuese, me autorizimin e administratës që i është drejtuar kërkesa dhe me kushtet që ka parashtruar kjo e fundit mund të vendosin, që me qëllim të hetimit të një shkeljeje doganore/tatimore:
 - (a) të lejoj në zyrat e saj ekzaminimin e dokumentacionit dhe ndonjë informacion tjetër në lidhje me atë shkelje doganore/tatimore, dhe të lejoj marrjen e kopjeve të këtyre informacioneve;
 - (b) të lejoj, në varësi të pikës c të këtij paragrafi, që zyrtarët e palës tjetër të jenë të pranishëm gjatë një hetimi të kryer nga administrata kërkuese në territorin e Palës që i është bërë kërkesa, nëse një gjë e tillë është konsideruar si tejet e rëndësishme për palën kërkuese, ndërsa që zyrtarët e palës kërkuese do të kenë vetëm rol monitorues.

Neni 7

Prania e zyrtarëve të njërës Palë me ftesë të Palës tjetër

1. Kur njëra palë e konsideron të dobishme dhe të përshtatshme për zyrtarët e palës tjetër që të jenë të pranishëm në territorin e vet, me qëllim që të ofrojnë ndihmesë për palën kërkuese, mund të ftojë zyrtarët në fjalë që të marrin pjesë, në varësi të kushteve të dakorduara në mes Palëve.

2. Një kërkesë e qartë do t'i paraprijë këtyre vizitave të akorduara dhe do të shpjegoj arsyen rationale të kërkesës, siç është nevoja për ekspertizë, dhe çështje tjera relevante të hetimeve.

Neni 8

Masat dhe detyrat për zyrtarët kërkues

1. Zyrtarët kërkues duhet që në çdo kohë të jenë në gjendje të ofrojnë dëshminë e identitetit të tyre zyrtar dhe statusin që kanë në administratën e tyre doganore apo tatimore.
2. Zyrtarët kërkues, derisa qëndrojnë në territorin e palës tjetër nën kushtet e kësaj marrëveshjeje, do të jenë përgjegjës për çdo shkelje që mund të kryejnë dhe do të gëzojnë, për aq sa parashikohet nga dispozitat ligjore dhe administrative të palës, të njëjtën mbrojtje sikurse nëpunësit e palës pritëse.
3. Zyrtarët kërkues nuk do të ndërmarrin asnjë veprim ligjor në emër të palës pritëse apo palës që përfaqësojnë nëse një veprim i tillë nuk është autorizuar nga pala pritëse.

Neni 9

Shpenzimet që lindin në zbatim të Marrëveshjes

1. Shpenzimet e bëra në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të mbulohen nga Pala që ka kërkuar një informacion apo praninë e zyrtarëve të saj përveç se kur palët mund të bien dakord që shpenzimet totale apo të pjesshme t'i ngarkohen palës pritëse.
2. Secila vizitë, sipas akteve ligjore të vendit nga i cili vijjnë zyrtarët, do të kompensohet në bazë të rregullimit ligjor të mbulimit të shpenzimeve në udhëtimet jashtë vendit për vizitat e zyrtarëve nga njëra palë tek tjetra.
3. Pala kërkuese për vizitat do të specifikojë me shkrim nëse do të mbulojë shpenzimet e zyrtarëve vizitues, duke specifikuar saktësisht se cilat shpenzime do të mbulojë, duke specifikuar sipas rastit fjetjen, transportin, ushqimin, pagesat dhe shpërblimet, shërbimet shëndetësore, shpenzimet për veprimet e ndërmarra zyrtare etj.

Neni 10

Shkëmbimi i informacionit të Inteligjencës

Palët bien dakord se me kërkesë apo me nismën e vet, të ndajnë informacionet e inteligjencës për çështjet dhe rreziqet e vendit të tyre që rrjedhin nga ekonomia informale dhe ekonomia e zezë, në veçanti kur këto rreziqe ndikojnë edhe interesat e palës tjetër.

Neni 11
Shkëmbimi i njohurive profesionale

1. Palët do të ndajnë njohuritë profesionale për fushat ekzistuese të veprimit apo si pasoje e masave të modernizimit me palën tjetër, në varësi të kushteve të pajtuara në mes palëve, përmes:
 - a. ofrimit të konsulencës nga zyrtarë të certifikuar të palës tjetër,
 - b. vizitave studimore të ekipeve të njëjës palë tek pala tjetër,
 - c. organizimit të trajnimeve të përbashkëta në territorin e njëjës palë,
 - d. formave të tjera të dakorduara me kushtet e tjera ad-hoc.
2. Të gjitha shpenzimet e për këto aktivitete do të mbulohen konform dispozitave të nenit 9 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12
Shkëmbimi i burimeve teknike

1. Palët, sipas kërkesës, duke u bazuar në kushte specifike ad-hoc, do të shkëmbejnë pajisje teknike për interes të palës kërkuese apo interes të përbashkët.
2. Shpenzimet për këto shkëmbime, përfshirë dëmtimet e mundshme, do të specifikohen në kushtet specifike në shkëmbime të tilla eventuale.

Neni 13
Përdorimi i informacionit

Çdo informacion i pranuar sipas kësaj Marrëveshjeje do të përdoret vetëm nga Pala kërkuese për procedim administrativ, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje

Neni 14
Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e Informacionit

1. Çdo informacion i pranuar sipas kësaj Marrëveshjeje, do të trajtohet si konfidencial dhe do të jetë subjekt i te paktën masave të njëjta të mbrojtjes dhe konfidencialitetit të vendit pranues, duke e trajtuar sikurse informacionet e kategorisë së njëjtë të pranuar brenda vendit, në vështrim të dispozitave ligjore dhe administrative.
2. Palët do të sigurojnë kushte të mjaftueshme për të siguruar se të dhënat personale janë mbrojtur konform dispozitave ligjore nacionale të aplikuara për këtë qëllim nga pala pranuese e informacionit.


3. Palët do të sigurohen se mbledhja, vendosja, ruajtja, përdorimi dhe shkatërrimi i të dhënave personale është bërë në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Në përputhje me dispozitat ligjore, secila palë do të mbajë përgjegjësi për dëmet eventuale të shkaktuara një individi, përmes shkëmbimit të informacionit nën kushtet e kësaj marrëveshjeje. Kjo do të konsiderohet edhe në rastet kur pala që ka siguruar informacionin e ka siguruar për persona të tjerë, apo procedimin në paragrafin 3 të këtij neni e ka bërë jo në përputhje me dispozitat e marrëveshjes.

Neni 15
Hyrja në fuqi

1. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Palët dhe lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe.
2. Secila Palë, mund të njoftojë palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e Marrëveshjes. Përfundimi do të ketë efekt tre muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë.
3. Marrëveshja mund të ndryshohet nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të Palëve.

Nënshkruar në Prishtinë, më **3 qershor 2016**, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku të dy tekstet janë njëllë të vlefshëm.

PËR
MINISTRINË E FINANCAVE TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS



PËR
MINISTRINË E FINANCAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

